

Waldschule GGS Lohmar - Hermann-Löns-Str. 37 - 53797 Lohmar

Drejtuar të gjithë prindërve të nxënësve të shkollës
Waldschule

**Waldschule Gemeinschafts-
grundschule Lohmar**
Hermann-Löns-Str. 37
53797 Lohmar

Telefon: (02246) 5131 und (02246) 9256754
Fax: (02246) 16332
Internet: <http://www.waldschule-lohmar.de>
e-Mail: sekretariat@waldschule-lohmar.de

Letra juaj/referenca juaj

Referenca ime

Data

Pö

Të dashur Prindër dhe fëmijë të shkollës Waldschule!

Fëmijët, kolegji, si edhe stafi i shkollës së hapur ditore, janë marrë në një proces të gjërë me rregullat e shkollës. Tashmë rregullat ekzistuese të vëllimshme i kemi reduktuar dhe përmbledhur në pak. Ato janë mbledhur në fletushkën e bashkëngjitur, së bashku me moton dhe parimin udhëheqës të shkollës sonë.

Ne ju lutemi si Prindër, që këto rregulla, për të cilat ne kemi rënë dakort për një **bashkëjetesë të mbarë**, dhe që të cilat vlejné **si për paraditen ashtu edhe për pasditen**, t'i diskutoni edhe njëherë bashkërisht me fëmijët dhe të nënshkruani. Fletushka qëndron si kujtim tek Ju. Luteni që pjesën e poshtme t'ia jepni mësuesit të klasës së fëmijës suaj.

Gjithashtu ne kemi rënë dakort edhe për **marrje masash në rastin e shkeljeve të rregullave**. Me këtë rast dëshiroj t'ju vë në dijeni sam ë poshtë:

Në rast se nuk do të respektohet një rregull, atëherë mund të shfrytëzohen pasojat e mëposhtme:

- të kërkohet falje (me letër, me një dëmshpërblim të vogël)
- të zbukurohet shkolla (të fshihet pluhuri nga lulet, të fshihet pluhuri nga objektet plastike...)
- të ndihmohet pasdite Zonja Reich në orën e guzhinës
- të informohen prindërit me shkrim
- të kopjohet rregulli i shkelur i dhe të sqarohet pas paraqitjes (në shtëpi dhe/apo në shkollë)
- të kontrollohet sipas udhëzimit renditja e librave në librari.

Përmes këtyre masave pedagogjike ne shpresojmë për një bashkëjetesë me respekt dhe kujdes. Luteni të na mbështesni në këtë.

Me nderime



M. Pössinger (Rektore)

Ne kemi diskutuar me fëmijën tonë broshurën lidhur me parimin udhëheqës dhe rregullat e shkollës dhe kemi marrë dijeni për përmbajtjen.

Emri i fëmijës

Klasa

Nënshkrimi i fëmijës/personit kujdestar

Orari i pritjes: e hënë – e premte
e premte

ora 8.00 - 12.30
ora 8.30 - 12.00

Lidhja bankare
Bank Postbank Hamburg

Adresa e e-mailit:

KB 20110022

Numri i kontos
2841841045

sekretariat@waldschule-lohmar.de